

RAPORT TRAJNIMI – 5 KORRIK 2024

Titulli: Zbatimi i Qasjes Reggio Emilia – Praktikat më të suksesshme

Data: 5 korrik 2024

Vendi: Qendra Mediale

Trajnere: Mevlude Murtezi

Pjesëmarrës: Studentë të vitit të 3-të dhe 4-t të Shkencave Sociale – AAB College

Qëllimi i trajnimit:

Të njoftojë studentët me parimet themelore të qasjes Reggio Emilia dhe të prezantojë mënyrat konkrete për përshtatjen dhe zbatimin e saj në institucionet edukative në Kosovë.

Përmbajtja e trajnimit:

- Historia dhe filozofia e Reggio Emilia
- Ambienti si faktor aktiv në të nxënit ("mësuesi i tretë")
- Fuqizimi i fëmijës si subjekt i procesit të të nxënit
- Dokumentimi pedagogjik si mjet reflektimi dhe planifikimi
- Roli i prindërve dhe komunitetit në edukim
- Praktika të suksesshme dhe raste konkrete nga vende të ndryshme

Rezultatet:

Studentët u angazhuan në diskutime të thelluara mbi filozofinë e qasjes Reggio Emilia dhe u nxitën të mendojnë në mënyrë kreative për zbatimin e saj në kontekstin tonë lokal.